



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 699, datë 26.11.2024

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI,
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatores znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekte, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. Njohuritë ligjore.

1.A.A. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e së tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e saj. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : “*Subjekti i rivlerësimit gjyqtari {...}, ka shfaqur aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për zbatimin e saj në rastin konkret. Në të drejtën civile, gjyqtari zgjidh drejt çështjet objekt gjykimi dhe vendimet e dhëna prej tij, në rast ankimi lihen në fuqi nga gjykata më të larta, ose nuk ankimohen nga palët (shih 3 dokumentet dhe 5 dosjet). Në të drejtën civile, gjyqtari ka njohuri në lidhje me paditë për pjesëtimin e pasurisë, ku zbaton rregulla procedurale për zhvillimin e gjykimit në dy faza, në respektim të neneve 371, 372 e 373 të K.Pr.Civile, si dhe nenit 207 të K.Civil (shih dokumentin 1), për përmbushjen e detyrimit kontraktor, që rrjedh nga kontratat e sipërmarrjes dhe nënsipërmarrjes të rregulluara nga*

nenet 850 e 857 të K.Civil, një kontratat për premtim shitje, por edhe kushtin penal të parashikuar nga neni 541 i K.Civil, si dhe kapitullin e detyrimeve të parashikuara nga nenet 419, 420, 476, 486 e 698 të K.Civil (shih dokumentet 2 e 3 dhe dosjen 1). Një dhe zbaton si duhet dispozitat e Ligjit nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Gjyqësor Përmbartimor Privat” dhe analizon detyrimet e rrjedhura nga kontratat e lidhura nga shërbimi përmbartimor privat në rastin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Një dhe zbaton dispozitat e Ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004, i ndryshuar “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve” (shih dosjen 3). Një dhe zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenet 32 e 388/2 të K.Pr.Civile për korrigjimin e gabimeve në rastin e dokumentacionit shtetëror që përmban të dhëna për vjetërsinë në punë të punonjësve, kur këto gabime nuk mund të korrigjohen në rrugë tjetër përveç asaj gjyqësore (shih dosjen 4). Gjithashtu ai ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale, sa i takon shqyrtimit të kërkesave që lidhen me masat e sigurimit personal (shih dosjen 5).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes :

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari e fillon arsyetimin e vendimit me përshkrimin e fakteve të çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtje të tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi kur është marrë një provë e tillë. Analiza e rrethanave të faktit bëhet në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e një rendi kronologjik dhe logjik. Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrihen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit.

Evidentohet një analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Rezulton se gjyqtari nuk përshkruan procedurën e ndjekur gjatë gjykimit dhe jo gjithmonë merr në shqyrtim dhe analizon elementë procedural lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e shqyrtimit të saj. Por konstatohet se në ato raste kur gjykimi ka vijuar në mungesë të palës së paditur, gjyqtari e parashtron këtë fakt, menjëherë pas përshkrimit të pretendimeve të palës paditëse të paraqitura gjatë gjykimit, duke parashtruar kështu faktin se pala e paditur nuk ka paraqitur prapsime lidhur me padinë.

Në çështjen penale me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal”¹, faktet gjenden të pasqyruara në mënyrë kronologjike në një pjesë të evidentueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese, pas së cilave gjyqtari parashtron vlerësimet për shkaqet e posaçme dhe

¹ Vendimi nr. 1533 akti, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

të dhënat që përlijin pranimin e kërkesës për vleftësimin e arrestit si dhe lidhur me masën e sigurimit të kërkuar nga organi i akuzës, duke mbërritur në përfundimin se i përshtatet kritereve të parashikuara në nenin 234 të K.Pr.Penale.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës çështja i është paraqitur gjykatës për shqyrtim, ku në rastin konkret, të gjitha vendimet burim vlerësimi i përkasin natyrës juridike civile, përveç çështjes/kërkesa penale me objekt “*Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal*”². Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një marrëdhënie pronësie, shpërblim dëmi, kundërshtim i vendimeve të ish KKK Pronave, pjestim pasurie marrëdhënie pune, etj.*), si dhe natyrën e kërkesës penale të paraqitur.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Vihet re se gjyqtari jo gjithmonë merr në analizë në mënyrë të shprehur juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes përse kohë që nuk ka pasur asnjë kërkesë nga palët. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes nuk është identifikuar gjithmonë në mënyrë specifike, por del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- ***Në drejtëm të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm material dhe procedural***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Referuar burimeve të vlerësimit, në këtë aspekt, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore, objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

² Vendimi nr. 1533 akti, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(i) Në vendimet gjyqësore civile, gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Punës, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet më konkretisht :

- a) Në vendimin gjyqësor me objekt “Shpërblim dëmi për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës...” gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 140, 141, 143, 144, 145, 153, 155 të K.Punës, në funksion të analizimit të fushës së zbatimit të këtij kodi, përkufizimit të marrëdhënies juridike të punës, llojin e kontratës, formën dhe përmbajtjen e saj, afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dëmshpërblimin për mosrespektim të afatit dhe procedurës si dhe pagimin e vjetërsisë në punë³;
- b) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrim për pagim shume si detyrim i prapambetur” gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat materiale nenet 419 dhe 420 të K.Civil, në funksion të analizimit të përkufizimit të marrëdhënies juridike të detyrimit, lindur nga kontrata e furnizimit etj.⁴;
- c) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrim për pagim shume që rrjedh nga marrëdhënie kontraktore, etj” gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat materiale nenet 455, 476, 486, 772 të K.Civil, duke dhënë përkufizimin e kontratës së furnizimit dhe ekzistencën e saj në përputhje me rastin konkret, mbi lidhjen e palëve me kushtet e kontratës, detyrimin për respektimin e saj duke u sjellë ndaj njëra tjetrës me kujdesin e duhur dhe me përpikmëri në përmbushjen e detyrimeve reciproke, kur lind e drejta e palës paditëse për të kërkuar shpërblim dëmi të pësuar si pasojë e mosrespektimit të kushteve të kontratës prej palës së paditur, ky dëm është fitimi që mund të nxirrej në kushtet normale të tregut (fitimi i munguar)⁵ ;
- d) Në vendimin gjyqësor me objekt “Pjestim pasurie” gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat materiale të Kodit Civil, nenin 207 mbi kriteret për lënien e sendit në natyrë; neni 191, ku gjykata ka orientuar palën ndërgjyqëse nëse do të heqë dorë nga pronësia si duhet të veprojë; nenin 373 lidhur me kushtet dhe nevojat kur gjykata duhet të procedojë me hartimin e ndonjë projekt pjesëtimi⁶;
- e) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrim për përmbushje detyrimi kontraktor” gjyqtari identifikon dhe citon nenet 476, 481, 690, 698, 850, 857 të K.Civil, duke dhënë përkufizimin e kontratës së nënsipërmarrjes, nënshkrimi saj rregullisht nga palët zë vendin e ligjit dhe duhet respektuar me përpikmëri, mangësia në ekzekutim çon në kërkimin për dëmshpërblim, mënyra e zgjidhjes së kontratës; nenin 514 të K.Civil kur lind e drejta për kërkimin e kompensimit të detyrimit. Gjithashtu gjyqtari referon dhe vendimin nr. 572 datë 11.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i cili ka interpretuar nenin 514 të K.Civil⁷;
- f) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrimi i palës së paditur të përmbushë detyrimin kontraktor për dorëzimin pasurie” gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e kushtit penal në marrëdhëniet juridiko civile, konkretisht nenin 541 të K.Civil në lidhje me kriteret ligjore të parashikuara duke dhënë përkufizimin e kushtit penal; nenin 543 të K.Civil në lidhje me të drejtën që i lind palës që krahas detyrimit për përmbushjen në mënyrën e duhur të detyrimit, në rastin konkret dorëzimi i objekteve, të kërkojë edhe pagimin e kushtit penal; nenin

³ Vendimi nr. 3345 datë 11.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴ Vendimi nr. 7437 datë 06.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵ Vendimi nr. 6974 datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶ Vendimi nr. 2895 datë 09.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷ Vendimi nr. 3109 datë 16.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

544 të K.Civil ku pas përllogaritjes së bërë nga eksperti, përligjet kërkimi i palës në lidhje me kushtin penal⁸;

- g) Në vendimin gjyqësor me objekt “Zgjidhja e kontratave të shërbimit përbarimor,” gjyqtari referon dispozita të Ligjit nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor privat”, në përputhje me Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 1240/5 datë 15.09.2009⁹;

Në vendimet gjyqësore civile, evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohen :

- a) Neni 42 i K.Pr.Civile lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes;
- b) Neni 32/c i K.Pr.Civile në lidhje me detyrimin që ka pala pretenduese për barrën e provës; nenin 253 të K.Pr.Civile lidhur me fuqinë provuese të dokumentit, përmbajtja e të cilit mund të kundërshtohet vetëm për falsitet¹⁰;
- c) Neni 185 i K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen mbi kërkesat për ndryshimin e objektit të padisë;
- d) Neni 201/1 i K.Pr.Civile në lidhje me arsyetimin e pushimit të gjykimit për kërkimin e palës në kushtet kur ka hequr dorë vetë nga gjykimi i padisë¹¹;
- e) Nenet 158, 158/a/1 të K.Pr.Civile, lidhur me veprimet përgatitore dhe zhvillimin e seancës;
- f) Nenet 371, 372, 373 të K.Pr.Civile në lidhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit të pjesëtimit të pasurisë në dy faza¹²;
- g) Neni 511 i K.Pr.Civile lidhur me lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar¹³;
- h) Nenin 160 të K.Pr.Civile në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë kundërpadia duke argumentuar mospranimin e saj për shqyrtim; nenin 212 të K.Pr.Civile lidhur me ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të marrë para se të depozitohet kërkesë padia e themelit; nenin 106 të K.Pr.Civile në lidhje me shpenzimet gjyqësore¹⁴;

(ii) Në vendimin gjyqësor penal/ kërkesë penale, nr. 1533 akti datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet personit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht identifikohet neni 291 i K.Penal në lidhje me akuzën “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”.

⁸ Vendimi nr. 5964 datë 07.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹ Vendimi nr. 1080 datë 16.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰ Vendimi nr. 7205 datë 20.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹¹ Vendimi nr. 7669 datë 13.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹² Vendimi nr. 2895 datë 09.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³ Vendimi nr. 6974 datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁴ Vendimi nr. 3109 datë 16.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari referon, si pjesë të integruar të arsytimit të këtij vendimit, këto dispozita të ligjit procedural penal, konkretisht, nenet 251, 252, 258, 259 të K.Pr.Penale lidhur me analizimin e konceptit të arrestimit në flagrancë, në vendimin me objekt “Vleftësim të ligjshëm arrestimi në flagrancë dhe caktim mase sigurimi”. Gjithashtu, gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim, konkretisht nenet 228, 229, 230, 234 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit;

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret, kjo edhe për shkak të natyrës së thjeshtë të çështjeve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale në rastet kur ata kanë qenë objekt i diskutimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedural lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtari ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore, lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.B. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke i dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’u japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 1.a.a “*Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast, me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretim të tyre në mënyrë abstrakte dhe individuale, i cili paraqitet konciz, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale bëhet nga ana e gjyqtarit, sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) *Në vendimet gjyqësore civile:* Në të gjitha vendimet e analizuara, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj, por duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, duke i rënditur në çdo rast, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara e të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari :

- a) Interpreton në mënyrë sistematike nenin 140 të K.Punës, në funksion të identifikimit të llojit të kontratës lidhur mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës. Gjyqtari interpreton në mënyrë literale dispozitën materiale (*nenin 143 të K.Punës*) duke argumentuar se kontrata është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme në dëm të punëmarrësit pa respektuar afatin 3 mujor. Gjithashtu analizohet neni 11 i K.Punës në lidhje me dokumentacionin e shqyrtuar, mbi respektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Më tej gjyqtari interpreton dispozitat materiale (*nenet 155 pika 3, nenet 152, 153 të K.Punës*), lidhur me faktin se kontrata është zgjidhur për shkaqe të pajustificuara dhe pasjell dëmshpërblimin ndaj punëmarrësit, si dhe diskrecionin e gjykatës në këtë aspekt, afatin e njoftimit dhe procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës duke analizuar në mënyrë të detajuar

provat shkresore, mbi të cilat provohen faktet e kërkimeve apo pretendimeve të palëve në gjykim¹⁵;

- b) Interpreton nenet 476, 481, 690, 698, 850, 857 të K.Civil, duke dhënë përkufizimin e kontratës së nënsipërmarrjes, nënshkrimi saj rregullisht nga palët zë vendin e ligjit dhe duhet respektuar me përpikmëri, mangësia në ekzekutim çon në kërkimin për dëmshpërblim, mënyra e zgjidhjes së kontratës; nenin 514 të K.Civil kur lind e drejta për kërkimin e kompensimit të detyrimit.¹⁶;
- c) Referuar interpretimit literal dhe sistematik të bërë dispozitave materiale përkatëse, gjyqtari ndalet në mënyrë të detajuar jo vetëm në interpretimin abstrakt të normës relevante (*nenet 296 e vijues të K.Civil*), por dhe tek ligji i posaçëm nr. 9235 datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*” i ndryshuar, duke përcaktuar afatin e paraqitjes së padisë për kundërshtimin e vendimit të AKKP. Në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë gjykata ndalet në interpretimin e nenit 18 të Ligjit të posaçëm nr. 9235 datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*” i ndryshuar, lidhur me afatin ligjor brenda të cilit mund të ngrihej një padi e tillë në gjykatë¹⁷;
- d) Interpreton nenet 455, 476, 486, 772 të K.Civil, duke dhënë përkufizimin e kontratës së furnizimit dhe ekzistencën e saj në përputhje me rastin konkret, mbi lidhjen e palëve me kushtet e kontratës, detyrimin për respektimin e saj duke u sjellë ndaj njëra tjetrës me kujdesin e duhur dhe me përpikmëri në përmbushjen e detyrimeve reciproke, kur lind e drejta e palës paditëse për të kërkuar shpërblim dëmi të pësuar si pasojë e mosrespektimit të kushteve të kontratës prej palës së paditur, ky dëm është fitimi që mund të nxirrej në kushtet normale të tregut (fitimi i munguar)¹⁸;
- e) Interpreton nenin 207 të K.Civil mbi kriteret për lënien e sendit në natyrë; neni 191, ku gjykata ka orientuar palën ndërgjyqëse nëse do të heqë dorë nga pronësia si duhet të veprojë; nenin 373 lidhur me kushtet dhe nevojat kur gjykata duhet të procedojë me hartimin e ndonjë projekt pjesëtimi¹⁹;
- f) Interpreton dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e kushtit penal në marrëdhëniet juridiko civile, konkretisht nenin 541 të K.Civil në lidhje me kriteret ligjore të parashikuara duke dhënë përkufizimin e kushtit penal; nenin 543 të K.Civil në lidhje me të drejtën që i lind palës që krahas detyrimit për përmbushjen në mënyrën e duhur të detyrimit, në rastin konkret dorëzimi i objekteve, të kërkojë edhe pagimin e kushtit penal; nenin 544 të K.Civil ku pas përlllogaritjes së bërë nga eksperti, përligjet kërkimi i palës në lidhje me kushtin penal²⁰;

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtari i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- a) Në vendimin penal me objekt “Vleftësim arrestimi dhe caktim mase sigurimi”, gjyqtari interpreton dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me

¹⁵ Vendimi nr. 3345 datë 11.03.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

¹⁶ Vendimi nr. 3109 datë 16.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁷ Vendimi nr. 2874 datë 28.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁸ Vendimi nr. 6974 datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹ Vendimi nr. 2895 datë 09.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁰ Vendimi nr. 5964 datë 07.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

konceptin e flagrancës dhe vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit²¹;

Në çështjet civile: Në funksion të evidentimit të marrëdhënies juridike, të krijuar mes palëve ndërgjyqëse e për pasojë konstatimin e juridiksionit dhe kompetencës lëndore në shqyrtimin e çështjes, gjyqtari interpreton nenet 41, 42 të K.Pr.Civile.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në vendimet e analizuara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- a) Në vendimin gjyqësor civil nr. 3109 datë 16.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në analizë të lindjes së të drejtës për kërkimit e detyrimit, gjyqtari ka cituar dhe referuar vendimin nr. 572 datë 11.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i cili ka interpretuar nenin 514 të K.Civil;
- b) Në vendimin gjyqësor civil nr. 3345 datë 11.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në analizë të përcaktimit të dëmshpërblimit që do t'i jepet punëmarrësit, gjyqtari citon se mban parasysh dhe orientimet e përcaktuara në vendimin unifikues nr. 19 datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me faktin se shkurtimi i numrit të punonjësve nuk konsiderohet si abuzim nga punëdhënësi dhe dëmi që i është shkaktuar punëmarrësit nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës;
- c) Në vendimin gjyqësor civil nr. 6243 datë 23.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në analizë të prapsimeve të parashtruara nga avokatura e Shtetit, gjyqtari citon se referenca e saj në vendimin unifikues nr. 4 datë 10.12.2013 dhe nr. 2 datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk ka lidhje me çështjen objekt gjykimi;

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtari gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtari njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin "Judicis est judicare secundum allegata et probata"*, sipas së cilit vendimmarrja e një gjyqtari duhet të bëhet në bazë të bindjes së brendshme të bazuar në prova.
- *Parimin e veprimit të ligjit civil në kohë* në funksion të evidentimit të ligjit të zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprimit juridik.
- *Parimin "Juria novit curia"*, sipas të cilit gjykata njih ligjin, në funksion të evidentimit se

²¹ Vendimi nr. 1533 akti, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

gjkata ka detyrimin për të bërë cilësim të saktë të fakteve, pa u lidhur me përcaktimin që bëjnë palët.

- *Parimin e mirëbesimit* mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në kuadër të analizës lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës si dhe *parimin e mbrojtjes së punëmarrësit*, në kuadër të analizës në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.
- *Parimet themelore të procesit gjyqësor civil* të parashikuar në nenet 10, 11, 12, 14, 16 etj. (*procesi i rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.*), mbi bazën e të cilave gjykata disponon për bazueshmërinë ose jo të padisë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe kryesisht atij material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe kujdesi për të zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. Arsyetimi ligjor

1.B.A. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtarja, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar²².

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

²² Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka shfaqur aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta, të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor...”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton se në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, gjithashtu dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit.

Gjuha teknike, përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave ligjore.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe

përdorimi i një gjuhë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsytimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke i bërë ato të kuptueshme dhe duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtari shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimi të saj, për lëshimin e urdhrin të ekzekutiv në paditë e detyrimit, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes, përdorimi i fjalëve dhe organizimi i arsytimit të vendimit gjyqësor në drejtim të shprehurit me gjuhë të thjeshtë dhe koncize, i bën vendimet të qarta dhe të kuptueshme. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mndësojnë leximi të organizuar që ofron kalim nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra në mënyrë logjike, ku dalin qartë dhe konkluzionet e gjykatës, të cilat vijnë si rrjedhë llogjike e të gjithë arsytimit në tërësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.B. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Subjekti i rivlerësimit harton vendime me strukturë të qëndrueshme, të mirëorganizuar dhe të standartizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit....”*.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve, duke e gërshetuar me provat e lejuara për shqyrtim, përshkrimin e pretendimeve të palëve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të tij të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke i ndarë me paragrafë, disa prej tyre të numërtuar, të cilat vijnë në rrjedhë kronologjike dhe logjike midis njëri- tjetrit, megjithëse nuk i ndanë vendimet në nënpjesë me fjali përshkruese, nga përmbajtja e tyre identifikohet qartë secila pjesë vendimt.

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese – arsyetuese (e ndarë në paragrafë, të cilët vijnë njëri pas tjetrit, duke filluar me rrethanat e faktet e provuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e palëve, pasqyrimin e ligjit të zbatueshëm dhe në analizën juridike), si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretaria gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë dhe e objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë (edhe pse jo me tituj të përcaktuar qartë si p.sh rrethanat e faktit, pretendimet e paëve, ligji i zbatueshëm, analiza juridike, por nga mënyra e pasqyrimin të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nënndarje), këto të fundit në paragrafë, disa prej të cilëve janë të numërtuar. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimit ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave.*

(ii) *pretendimet e palëve*, pjesë në të cilën gjyqtari pasqyron pretendimet dhe prapësimet e secilës palë të paraqitur në gjykim, provat e referuara nga palët, si dhe referencat ligjore mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, pretendime këto cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur dhe të rënditura nga gjyqtari.

(iii) *analizën ose vlerësimin ligjor*, duke e filluar këtë pjesë me paraqiten e paraqitjen e konkluzionit të gjykatës lidhur me pranimin apo rrëzimin e padisë, të parashtruar më një fjali, për të vijuar me identifikimin dhe citimin e neneve përkatëse të ligjit material dhe/ose procedural të zbatueshëm, paraqitjen dhe analizën e çështjes, duke integruar në të, kur është vlerësuar e nevojshme edhe interpretimin e pavarur të dispozitave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes. Në këtë pjesë të vendimit, gjyqtari merr në analizë edhe pretendimet e palëve, duke i analizuar ato në mënyrë specifike, duke i dhënë përgjigje të argumentuar secilit prej tyre. Në disa vendime, gjyqtari në këtë pjesë, pas dhënies së konkluzionit lidhur me padinë ka marrë në analizë edhe aspekte që lidhen me procedurën e gjykimit, konkretisht vlerësimi në lidhje me juridiksionit, kompetencës, apo momentin e paraqitjen se padie etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit gjyqësor si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për pakësim të objektit të padisë. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në pjesën tjetër të vendimeve, gjyqtari organizon pjesën e arsytimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërtimeve objekt padie apo kërkesës penale, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretarisë gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike (*për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit*). Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile, (ii) nenin 259 dhe 245 të K.Pr.Penale, në vendimin për vleftësim arrestimi në flagrancë dhe caktim mase sigurimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes, por jo shumë në aspektin vizual, por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të

qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

1.B.C. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka shfaqur aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta, të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standartizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit. Qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë, kur është rasti shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit, i cili formalisht tregon shërbimin përmbartimor shtetëror ose privat, si subjekti që ngarkohet për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi, si dhe tregon faktin që urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cënuar nga Gjykata e Apelit ose*

Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët, edhe për palët në mungesë. Ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, ku në të gjitha rastet pasqyrohet saktë shkaku dhe baza ligjore (shih 5 dosjet)”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i veçantë gjyqtarit në arsytim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithmonë merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat gjithashtu janë evidentuar në vendimi.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin individual të ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura.

Evidentohet fakti që në arsytimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile, gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile.

Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsytimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, ecurinë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kritereve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në fund të pjesës arsyetuese. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsytimit (por në pjesën përkatëse të

arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në secilin vendim, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.A. Respektimi i afateve ligjore

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :*“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...}, ka qene në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 7 muaj e 27 ditë (shih dosjen 4). Në të tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 5 muaj e 22 ditë (shih dosjen 1), për 4 muaj e 22 ditë (shih dosjen 2) si dhe për 1 muaj e 22 ditë (shih dosjen 3). Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në katër raste, është respektuar plotësisht afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 1-3 e 5). Në dosjen 4 afati standard është tejkaluar, për shkak se ka patur shtyrje të disa seancave me kërkesë të palëve për zgjidhjen e konfliktit jashtëgjyqësisht, si dhe ka ndikuar leja vjetore e gjyqtarëve e muajit gusht. Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se ato gjykime janë realizuar përtej afatit standard të gjykimit duke u llogaritur afati nga data e regjistrimit të çështjes, konkretisht për 1 vit e 2 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 1), për 8 muaj e 22 ditë (shih dokumentin 2) dhe për 10 muaj e 7 ditë (shih dokumentin 3)”*.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short dhe tre vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Civile, për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor, për përfundimin e tyre. Edhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit, por në disa raste parashikohet afat për shqyrtimin e kërkesave penale.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht:

- Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), ku parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale.²³ Referuar vendimit gjyqësor penal nr. 1533 akti, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë më datë 10.06.2016 dhe ka përfunduar po më datë 10.06.2016, pra brenda afatit ligjor prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor gjykimi, duke iu referuar çështjes së analizuar më sipër në të cilën afati ligjor i gjykimit është respektuar dhe prezumimit se në mungesë të të dhënave të tjera që mund të ndikojnë në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është e lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar, për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton në nivelin 0 % (0-10 %-10 pikë).

2.A.B. Plotësimi i standardeve minimale kohore

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

²³ Neni 259 i K.Pr.Penale parashikon se “...5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë”.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 2.A.A “*Respektimi i afateve ligjore*”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10²⁴ (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr. 261/2 të ish KLD-së, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje civile të përgjithshme :

- **Dosja 1-** Çështja civile nr. 9362 regjistri, datë regjistrimi 21.03.2014, e përfunduar me vendimin nr. 8800, datë 15.09.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 24.03.2014 dhe ka përfunduar më datë 15.09.2014). Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 22 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 2-** Çështja civile nr. 11964/2421 regjistri, datë regjistrimi 23.09.2015, e përfunduar me vendimin nr. 1080, datë 16.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 25.09.2015 dhe ka përfunduar më datë 16.02.2016). Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 22 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 3-** Çështja civile nr. 8827 regjistri, datë regjistrimi 26.05.2015, e përfunduar me vendimin nr. 6243, datë 23.07.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 01.06.2015 dhe ka përfunduar më datë 23.07.2015). Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 22 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 4-** Çështja civile nr. 8639 regjistri, datë regjistrimi 24.02.2014, e përfunduar me vendimin nr. 10144, datë 22.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 25.02.2014 dhe ka përfunduar më datë 22.10.2014). Gjykimi ka zgjatur 7 muaj e 27 ditë, **jashhtë afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Megjithatë, po të zbresim nga ky afat, muajin gusht, gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen e zakonshme, rezulton se çështja ka zgjatur 6 muaj e 26 ditë, duke e tejkalar këtë afat me 26 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i paërfillshëm e për pasojë do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit minimal kohor prej 6 muajsh të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;

²⁴ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi, konkretisht vendimi gjyqësor/ kërkesë penale me nr. 1533 akti, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- **Dosja 6 (1)** – Çështja civile nr. 7449 regjistri, datë regjistrimi 16.01.2014, e përfunduar me vendimin nr. 2874, datë 28.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 17.01.2014 dhe ka përfunduar më datë 28.02.2014). Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 11 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 7 (2)**- Çështja civile nr. 7480 regjistri, datë regjistrimi 17.01.2014, e përfunduar me vendimin nr. 3345, datë 11.03.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 17.01.2014 dhe ka përfunduar më datë 11.03.2014). Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 24 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 8 (3)**- Çështja civile nr. 8787 regjistri, datë regjistrimi 25.05.2015, e përfunduar me vendimin nr. 7437, datë 06.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 26.05.2015 dhe ka përfunduar më datë 06.10.2015). Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 10 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 9 (4)**- Çështja civile nr. 9619 regjistri, datë regjistrimi 16.06.2015, e përfunduar me vendimin nr. 7669, datë 13.07.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 17.06.2015 dhe ka përfunduar më datë 13.10.2015). Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 26 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 10 (5)**- Çështja civile nr. 8071 regjistri, datë regjistrimi 12.04.2016, e përfunduar me vendimin nr. 6974, datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 13.04.2016 dhe ka përfunduar më datë 13.09.2016). Gjykimi ka zgjatur 5 muaj, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 11 (6)**- Çështja civile nr. 9722 regjistri, datë regjistrimi 25.05.2016, e përfunduar me vendimin nr. 7205, datë 20.09.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është caktuar me short më datë 30.05.2016 dhe ka përfunduar më datë 20.09.2016). Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 20 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Vendimi 1**- Vendimi gjyqësor civil nr. 2895 datë 09.04.2015 i i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është regjistruar më datë 05.02.2014 dhe ka përfunduar më datë 09.04.2015). Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 29 ditë, **jashtë afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve; Në përlogaritjen e kohës së gjykimit nuk është përfshirë periudha e lejes vjetore e vitit 2014, si dhe periudha e mbarjtes së dosjes në muajin janar, prej 15 ditë.
- **Vendimi 2**- Vendimi gjyqësor civil nr. 3109 datë 16.04.2015 i i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është regjistruar më datë 25.07.2014 dhe ka përfunduar më datë 16.04.2015). Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 22 ditë, **jashtë afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Nëse nga ky afat zbresim periudhën gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen e zakonshme, si dhe periudhën e mbartjeve të dosjeve në muajin janar, rezulton se gjykimi ka përfunduar për një periudhë prej 7 muaj e 7 ditë, përsëri jashtë afatit 6 mujor të standardit minimal të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve..
- **Vendimi 3**- Vendimi gjyqësor civil nr. 5964 datë 07.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (është regjistruar më datë 31.08.2015 dhe ka përfunduar më datë 07.07.2016). Gjykimi ka zgjatur

10 muaj e 7 ditë, ***jashtë afatit 6 mujor*** të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Nëse nga ky afat zbresim periudhën gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen e zakonshme, si dhe periudhën e mbartjeve të dosjeve në muajin janar, rezulton se gjykimi ka përfunduar për një periudhë prej 8 muaj e 22 ditë, përsëri jashtë 6 mujor të standardit minimal të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 13 (trembëdhjetë) çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së, pasi 3 (tre) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra, në total 23 % të çështjeve, janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për 77 % të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 23 % përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë (Mbi 20-30%- 3).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtarja ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Në lidhje me kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët, që mund të çojë në një pikëzim më të lartë, se ai që rezulton nga analiza matematikore, rezulton si më poshtë:

- Çështja civile që i përket vendimit gjyqësor nr. 2895 datë 09.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt “Pjestimi i pasurisë apartament banimi...”, e zgjedhur nga vete gjyqtari, rezulton se regjistruar më datë 05.02.2014 dhe ka përfunduar më datë 09.04.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 1 vit 28 ditë, pra ***jashtë afatit 6 mujor*** të standardit minimal kohor për gjykimet civile. Në përlllogaritjen e kohës së gjykimit nuk është përfshirë periudha e lejes vjetore e vitit 2014, si dhe periudha e mbarjes së dosjes në muajin janar, prej 15 ditë. Duke qenë se është vendim gjyqësor i zgjedhur nga gjyqtari nuk është administruar dosja gjyqësore, nga ku mund të rezultonin të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes. Megjithatë, referuar objektit të çështjes, konstatohet se jemi përpara një gjykimi me objekt pjesëtim pasurie, për të cilin zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 369 e vijues të K.Pr.Civile, që parashikon zhvillimin e gjykimit në dy faza. Në fazën e parë gjykata vendos nëse do të lejohet pjesëtimi i pasurisë/sendit dhe nëse po përcaktohen bashkëpronarët me pjesët takuese të tyre. Nga këtij vendimi të gjykatës (edhe pse jopërfundimtar) palët kanë të drejtën e

ankimit në gjykatën më të lartë. Pasi vendimi i gjykatës dhënë për fazën e parë të këtij pjesëtimi merr formë të prerë, rifillon procesi i gjykimit në lidhje me fazën e dytë ku vendoset përfundimisht për sendin/pasurinë dhe kërkimet e në objektin e padisë. Në këtë fazë, referuar objektit të padisë, por edhe përmbajtjes së gjykimit rezulton se është marrë edhe prova me ekspert. Sa më sipër, vlerësohet se në këtë rast ka qenë e pamundur që gjykata të realizojë një proces të rregullt dhe ta përfundojë gjykimin, brenda afatit standard të gjykimit 6 mujor.

Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti referuar natyrës dhe mosmarrëveshjes civile, ku gjykimi zhvillohet në dy faza, procedurë e cila ka detyruar gjykatën të shtyjë seancën disa herë duke ndërprerë gjykimin deri në marrjen formë të prerë të vendimit lidhur me fazën e parë. Më tej referuar natyrës së gjykimit, ka qenë e domosdoshme marrja e mendimit të ekspertit me njohuri të posaçme për vlerësimin e pasurive të paluajtshme pasi ka rezultuar e pamundur ndarja në natyrë.

- Çështja civile që i përket vendimit gjyqësor nr. 3109 datë 16.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt “*Detyrimin e të paditurit të përmbushë detyrimin ...*”, i zgjedhur nga vete gjyqtari, rezulton se është regjistruar më datë 25.07.2014 dhe ka përfunduar më datë 16.04.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 8 muaj 22 ditë, pra ***jashhtë afatit 6 mujor*** të standardit minimal kohor për gjykimet civile. Duke qenë se është vendim gjyqësor i zgjedhur nga gjyqtari nuk është administruar dosja gjyqësore, nga ku mund të rezultonin të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes. Megjithatë, nga përmbajtja e vendimit, rezulton se palët ndërgjyqëse janë dy shoqëri tregtare, ku gjatë gjykimit pala e paditur ka paraqitur kundërpadi.
- Çështja civile që i përket vendimit gjyqësor nr. 5964 datë 07.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt “*Detyrimi i palës së paditur të përmbushë detyrimin kontraktor për dorëzimin e katër apartamenteve, ..., të katër garazheve të mbuluara, sipas kontratës premtim shitje të pasurisë së paluajtshme me nr. 4479 rep. 1945 kol. datë 28.07.2008. Detyrimi të paditurit të paguajë penaltitetet për vonesat ...*”, rezulton se është regjistruar më datë 31.08.2015 dhe ka përfunduar më datë 16.04.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 10 muaj 7 ditë, pra ***jashhtë afatit 6 mujor*** të standardit minimal kohor për gjykimet civile. Nëse nga ky afat zbresim periudhën gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen e zakonshme, si dhe periudhën e mbartjeve të dosjeve në muajin janar, rezulton se gjykimi ka përfunduar për një periudhë prej 8 muaj e 22 ditë. Duke qenë se është vendim gjyqësor i zgjedhur nga gjyqtari nuk është administruar dosja gjyqësore, nga ku mund të rezultonin të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes. Megjithatë, nga përmbajtja e vendimit konstatohet se në këtë gjykim janë marrë dy lloje aktesh ekspertimi, pasi zgjidhja e çështjes kërkonte njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit dhe në fushën e kontabiliteti, ku fillimisht përgatitja e tyre nga ekspertet ka kërkuar një kohë të mjaftueshme, si dhe njohja me to normalisht ka sjellë shtyrjen e seancave, aq më tepër kur objekti i kërkesë padisë ka qenë lirimi dhe dorëzimi i disa pasurive të paluajtshme, objekti kontrate.

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior, në pikën 3, shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve*

kundërshtare.”. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar në total për 3-vite periudhë vlerësimi 769 çështje, nga të cilat 453 çështje themeli në tre vite, mesatarisht 151 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje në vit, duke tejkaluar këtë standard me 31 çështje apo me 25.8 %. Megjithatë, po të marrim si periudhë vlerësimi, kohën gjyqtari ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultoi se për periudhën janar 2014-08.10.2016, pra për një periudhë prej rreth 2 vjet e 9 muaj, ka përfunduar 387 çështje me palë kundërshtare, apo rreth 140 çështje me palë kundërshtare në vit.

Në lidhje me kushtet e punës, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit, konkretisht nga data 06.05.2011 - 06.05.2016, pra thuajse gjithë periudhën e vlerësimit, gjyqtari {...} është zgjedhur si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke ushtruar njëkohësisht edhe detyrat e gjyqtarit, çka nënkupton angazhimin e tij dhe në detyrat e anëtarit të ish KLD.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 23 %, përqindje që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 3 pikë;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, të cilat referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore (të zgjedhur nga gjyqtari e për pasojë nuk është administruar dosja gjyqësore), nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit, por që lidhen me ecurinë e procesit gjyqësor;
- (iii) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit gjatë së cilët gjyqtari ka përfunduar 769 çështje, nga të cilat 453 çështje themeli në tre vite, mesatarisht 151 çështje themeli në vit, duke e tejkaluar standardin minimal sasior “jo më pak se 360 çështje për 3/vjet” , me më shumë se 25.8 %, në raport me standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së;
- (iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është me e gjerë se treguesi i “respektimit të afateve ligjore”,
- (v) analizën jo vetëm matematikore, por edhe logjike të të dhënave statistikore, rezulton se zgjatja e gjykimeve kryesisht në disa prej çështjeve civile të analizuar më lart, nuk ka ardhur për shkaqe që lidhen me mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit, por me nevojshmërinë e kryerjes së veprimeve procedurale;
- (vi) pamundësinë objektive për të lënë zhvillimin e seancave përgatitore e atyre gjyqësore në një kohë më të afërt nga seanca paraardhëse, për shkak të natyrës së veprimit procedural si dhe ngarkesës totale në punë të gjyqtarit, por edhe angazhimit të tij si anëtar i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

pavarësisht përqindjes së mësipërme, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 23 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

2.A.C. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 2.A.A “Respektimi i afateve ligjore”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit²⁵.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është rreth 160 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj. Në përlllogaritjen e kohës së gjykimit për çështjet, nuk është përfshirë periudha e lejes vjetore, si dhe periudha e mbarjes së dosjes në muajin janar, për disa çështje, të cilat janë përfunduar tej standardin minimal kohor prej 6 muajsh, të llogaritur tek treguesi, lejes, si dhe periudha e mbartjes së dosjes në muajin janar, të llogaritur tek treguesi « A.B. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

²⁵ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

- ii. Në kategorinë e çështjeve “*Marrëdhënie pune*”, që është vetëm një çështje, koha mesatare që i dedikohet kësaj çështje është 54 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.*

2.A.Ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit dhjetor 2013 e në vazhdim, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe duke përcaktuar seksionin civil të kësaj gjykate, pra fushën e të drejtës civile. Në formularin e vetëdeklarimit në rubrikën e të dhënave statistikore ai ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për periudhën 2014 - 2016 gjithsej 1018 çështje, ku ka përfunduar 890 çështje, duke mbartur vitin e fundit 136 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 87.4 %.*

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit dhjetor 2013- 08.10.2016, gjyqtari {...}, ka përfunduar gjithsej 703 çështje gjyqësore, nga të cilat 387 çështje civile themeli dhe civile tregtare, 268 janë kërkesa civile, si dhe 48 janë kërkesa penale të llojit masa sigurimi”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtari {...} ka përfunduar gjithsej 769 çështje gjyqësore, nga të cilat 387 çështje civile të përgjithshme, 12 tregtare, 14 çështje familjare, 273 kërkesa civile, 4 urdhëra ekzekutimi, 58 masa sigurimi personal, 4 kërkesa penale dhe 17 penale themeli.

Nga të dhënat statistikore rezultoi se ai është caktuar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë në datë 20.12.2013 dhe ka filluar t'i caktohen çështje me short vetëm në muajin janar të vitit 2014. Për periudhën janar 2014- 08.10.2016 ai ka gjykuar 703, nga të cilat 375 çështje civile të përgjithshme, 12 tregtare, 268 dhe 48 masa sigurimi personal. Sipas informacionit të marrë nga burimet njerëzore të KLGJ, të pasqyruar edhe në raportin Analitik, rezultoi se për periudhën 06.05.2011- 06.05.2016 Z. Caka ka ushtruar edhe detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Referuar këtyre të dhënave statistikore, rezultoi se gjyqtari {...} për gjithë periudhën e vlerësimit 08.10.2013- 08.10.2016, konkretisht periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i janë caktuar dhe ka shqyrtuar këto çështje, të ndarë për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014), gjyqtarit i janë caktuar për gjykim 275 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total 242 çështje, duke mbartur 33 çështje, duke realizuar një rendiment prej 88 %.

Për vitin 2015 (01.01.2015-31.12.2015), gjyqtarit i janë caktuar për gjykim 232 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total 184 çështje, duke mbartur 48 çështje, duke realizuar një rendiment prej 81 %.

Për vitin 2016 (01.01.2016-08.10.2016), gjyqtarit i janë caktuar për gjykim 351 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total 276 çështje, nga të cilat 228 civile dhe 48 masa sigurimi personal, duke mbartur 123 çështje deri në përfundim të vitit kalendarik, duke realizuar një rendiment prej 78.6 %.

Referuar sa më sipër, rezultoi se gjatë periudhës Janar 2014- deri në 08.10.2016, për të cilën ka të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara dhe të përfunduara nga gjyqtari, sipas të cilit rezultoi se gjyqtarit i janë caktuar gjatë periudhës 858 çështje dhe ka përfunduar 702 çështje. Nga llogaritja e numrit të çështjeve të caktuara me numrin e çështjeve të përfunduara me vendim, gjatë periudhës janar 2014-08.10.2016, për të cilën ka të dhëna, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjatë kësaj periudhe është 81.8 %. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, ky rendiment pikëzohet me 4 pikë (Mbi 81-87%). Ndërsa në Raportit për analizimin e aftësive profesionale, rendimenti është llogaritur në bazë të vetdeklarimit të gjyqtarit për numrin e përgjithshëm të çështjeve të caktuara dhe të përfunduara gjatë periudhës 2014 – 2016, i cili ka rezultuar në masën e 87.4 %.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit, për periudhën Janar 2014- 08.10.2016 gjyqtari ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në seksionin civil të përgjithshëm. Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “e” të vendimit të KLD, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë i dhomës civile, si relator i seksionit të përgjithshëm, brenda një viti kalendarik gjykon jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare.

Sipas të dhënave statistikore, rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar në total për 3-vite periudhë vlerësimi 769 çështje, nga të cilat 453 çështje themeli në tre vite, mesatarisht 151 çështje themeli në vit. Megjithatë, po të marrim si periudhë vlerësimi, kohën gjyqtari ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjqësor Tiranë, rezultoi se për periudhën janar 2014- 08.10.2016, pra për një periudhë prej rreth 2 vjet e 9 muaj, ka përfunduar 387 çështje me palë kundërshtare, apo rreth 140 çështje me palë kundërshtare në vit, duke tejkaluar standardin sasior me rreth 20 çështje themeli në vit.

Gjithashtu, rezultoi se nga data 06.05.2011- 06.05.2016 ai ka ushtruar edhe detyrën e anëtarit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, çka nënkupton një ngarkesë më të ulët në punë në raport me gjyqtarët e tjerë, megjithëse kjo nuk është e rregulluar me ligj.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 81.8 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 4 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtari ka tejkaluar në çdo vit stardadin minimal të miratuar, me rreth 60 çështje me palë kundërshtare për 2 vite e 9 muaj punë, faktin se thuajse në të gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtari ka ushtruar edhe detyrën e ish anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vlerësohet se mund të arrihet në një pikëzim më të lartë se ai që i përket rendimetit të gjyqtarit, duke u pikëzuar me 10 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari duhet të pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se në çdo vit e ka tejkaluar standatim minimal sasior dhe ngarkesa e tij në punë, referuar kushteve të punës ka qenë e lartë, në raport edhe me detyrën e tij si anëtar i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

2.A.D. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se : *“Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} ka respektuar në të pesta rastet aftët ligjore për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në kryesëtarinë e gjykatës. Konkretisht, arsytimi i vendimeve është kryer për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 10 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 1 ditë nga shpallja (shih dosjet 3 dhe 5) dhe për 7 ditë nga shpallja (shih dosjen 4)”*.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308/2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Dosjet e përzgjedhura me short, të administruara gjatë procesit të rivlerësimit²⁶, janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

²⁶ Sipas Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

Dosja 1- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 8800, datë 15.09.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 19.09.2014 - (pas 4 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 2- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 1080, datë 16.02.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 26.02.2015 - (pas 10 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 3- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 6243, datë 23.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 24.07.2015 - (pas 1 dite), brenda afatit ligjor;

Dosja 4- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 10144, datë 22.10.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 29.10.2014 - (pas 7 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 5- Kërkesa penale e përfunduar me vendimin nr. 1533 akti, datë 10.06.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 10.06.2016 - (pas 5 ditësh), brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 113 të K.Pr.Penale referuar objektit të çështjes;

Ndërsa 6 (gjashtë) dosjet e përzgjedhura me short, për efekt të këtij procesi vlerësimi (gradim), sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

Dosja 6 (1) – Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 2874, datë 28.02.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 07.03.2014 - (pas 8 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 7 (2) - Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 3345, datë 11.03.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 13.03.2014 - (pas 2 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 8 (3) - Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 7437, datë 06.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 12.10.2015 - (pas 6 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 9 (4) - Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 7669, datë 13.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 15.10.2015 - (pas 2 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 10 (5) - Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 6974, datë 13.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 20.09.2016 - (pas 7 ditësh), brenda afatit ligjor;

Dosja 11 (6) - Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 7205, datë 20.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është dorëzuar në datën 29.09.2016 - (pas 9 ditësh), brenda afatit ligjor;

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Civile themeli” është 5.6 ditë dhe për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale” është 5 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” duhet të vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5), me 4 seanca (shih dosjen 3), me 6 seanca (shih dosjen 1), me 7 seanca (shih dosjen 2) dhe me 9 seanca seanca (shih dosjen 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 27 seanca gjyqësore, nga të cilat 21 seanca gjyqësore kanë qenë produktive. Pengesë në 6 seanca gjyqësore

joproduktive janë bërë mungesa e palës së paditur (probleme me adresat e të paditurve), mungesa e gjyqtarit vetëm në një rast për shkak të pjesëmarrjes së tij në një trajnim të organizuar nga Shoqata e Gjyqtarëve (mungesë e justifikuar pasi i shërben thelletit të njohurive profesionale të gjyqtarit), shtyrja e seancës për t'u dhënë mundësi palëve që ta zgjidhin mosmarrëveshjen jashtëgjyqësisht, me kërkesë për shtyrje për saktësimin e objektit të padisë, apo qënies në gjykime të tjera. Në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk është konstatuar shtyrja e ndonjë seance për shkaqe të pajustificuara. Seancat e vëzhguara janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre dhe si në proces verbalin e veprimeve përgatitore ashtu edhe në proces verbalin gjyqësor, në çdo rast, është shënuar ora e fillimit dhe ora e mbarimit të seancës. Në përfundim të seancës, proces verbali i veprimeve përgatitore apo proces verbali i seancës gjyqësore, është nënshkruar rregullisht nga gjyqtari dhe sekretaria gjyqësore që e asistoi atë gjatë procesit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, pasi dosja me nr. 5 (me objekt “*Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi personal*”), i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Dosja 1- Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 8800, datë 15.09.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë rezultuar produktive.

Dosja 2- Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 1080, datë 16.02.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 6 seanca gjyqësore.

Dosja 3- Në çështjen të përfunduar me vendimin nr. 6243, datë 23.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore.

Dosja 4- Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 10144, datë 22.10.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 6 seanca gjyqësore.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Dosja 6 (1) – Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 2874, datë 28.02.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore.

Dosja 7 (2) - Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 3345, datë 11.03.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore.

Dosja 8 (3) - Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 7437, datë 06.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Rezulton të jetë zhvilluar 1 seancë gjyqësore, ku është shpallur dhe vendimi përfundimtar.

Dosja 9 (4) - Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 7669, datë 13.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore.

Dosja 10 (5) - Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 6974, datë 13.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 6 seanca gjyqësore.

Dosja 11 (6) - Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 7205, datë 20.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 5 seanca gjyqësore.

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrohen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (civile themeli) varion nga 1 deri në 6 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.6 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile*). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët të cilave iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *njoftimi i ndryshimit procedural si pakësim objekti i padisë, njoftimi i ekspertit, dhënia kohë ekspertit për t'u përgatitur në lidhje me pyetjet dhe pretendimet e parashtruara nga palët, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, dhënia kohë palëve për t'u përgatitur me shkrim për konkluzione përfundimtare etj.*

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

2.B.B. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në 5 dosjet e vëzhguara, ku nuk janë konstatuar mangësi në organizimin, planifikimin dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e tij. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa, nëpërmjet vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile apo për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale (shih 5 dosjet).

Në katër çështje civile themeli të vëzhguara, gjyqtari ka kryer rregullisht veprimet përgatitore (shih dosjet 1-4 dosjet). Veprimet përgatitore janë dokumentuar rregullisht me proces verbal i mbajtur nga sekretaria gjyqësore e gjyqtari. Është konstatuar se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi seancës përgatitore duke marrë masa që kjo seancë të ishte produktive dhe e efektshme. Në seancat përgatitore ai ka kryer veprimet e nevojshme procedurale, me qëllim përgatitjen e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Efektiviteti i veprimeve përgatitore ka sjellë si pasojë përfundimin e çështjes në pak seanca gjyqësore.

Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5), me 4 seanca (shih dosjen 3), me 6 seanca (shih dosjen 1), me 7 seanca (shih dosjen 2) dhe me 9 seanca seanca (shih dosjen 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 27 seanca gjyqësore, nga të cilat 21 seanca gjyqësore kanë qenë produktive. Pengesë në 6 seanca gjyqësore joproductive janë bërë mungesa e palës së paditur (probleme me adresat e të paditurve), mungesa e gjyqtarit vetëm në një rast për shkak të pjesëmarrjes së tij në një trajnim të organizuar nga Shoqata e Gjyqtarëve (mungesë e justifikuar pasi i shërben thellesit të njohurive profesionale të gjyqtarit), shtyrja e seancës për t’u dhënë mundësi palëve që ta zgjidhin mosmarrëveshjen jashtëgjyqësisht, me kërkesë për shtyrje për saktësimin e objektit të padisë, apo qënies në gjykime të tjera. Në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk është konstatuar shtyrja e ndonjë seance për shkaqe të pajustificuara. Seancat e vëzhguara janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre dhe si në proces verbalin e veprimeve përgatitore ashtu edhe në proces verbalin gjyqësor, në çdo rast, është shënuar ora e fillimit dhe ora e mbarimit të seancës. Në përfundim të seancës, proces

verbali i veprimeve përgatitore apo proces verbali i seancës gjyqësore, është nënshkruar rregullisht nga gjyqtari dhe sekretaria gjyqësore që e asistoi atë gjatë procesit

Gjatë gjykimit, gjyqtari {...} zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje të gjitha çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose brenda afatit ligjor, pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara, janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, (shumë pak prej tyre mbajtur me regjistrim audio), si dhe dokumentohen në mënyrë të përmblodhur me shkrim nga sekretaria gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara nga ligji për gjykimin në shkallë të parë, në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës që nuk është paraqitur, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, ndonjë rast me vonesa të papërfilshme.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Gjithashtu, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie, në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat procedural të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.A. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar magësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesë padia apo kërkesa penale për gjykim, proces verbal i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, konkluzionet përfundimtare etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas

kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes, në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, aktet hetimore, procesverbal i seancës gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Po ashtu, renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short,

nuk janë konstatuar magësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesat për saktësim objekti, kërkesat për shtyrje seance, konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

DUKE IU REFERUAR BURIMEVE TË VLERËSIMIT, REZULTON SE GJYQTARI KA SHKALLË AFTËSIE SHUMË TË LARTË NË KËTË TREGUES.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, konstatohet se në periudhën e rivlerësimit "8 tetor 2013 - 8 tetor 2016", në ish Inspektoratin e ish KLD-së, nuk është paraqitur asnjë lloj ankese, si në drejtim të aftësive profesionale ashtu edhe në drejtim të respektimit etik për gjyqtarin {...} (shih të dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...}”.*

3.A.A. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në Inspektoriatin e ish KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional 08.10.2013 – 08.10.2016, nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtarit {...}”.*

3.B.A. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Nga vendimin nr. 663 datë 23.05.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer, konkludohet se : *“...10.6 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me balancën negative -1,287,574 lekë, e cila krijohej në vitet 2013 – 2014, për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave nga aktiviteti i personit fizik të bashkëshortes (noteri). Gjatë hetimit administrativ u provua se për vitin 2014 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i saj noteri ka përfituar të ardhura të ligjshme në shumën neto 3,175,629 lekë, të ardhura këto të konfirmuara dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në përgjigjen që kjo e fundit i ka dërguar Komisionit. Këto janë konsideruar nga Komisioni të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi vijnë nga burime të ligjshme, por nga leximi i pasqyrave financiare të personit fizik “O. D.” (notere) në dukje këto të ardhura ishin tek “arka” dhe nuk ishin përdorur nga subjekti i rivlerësimit për të krijuar gjendjen cash të deklaruar.*

10.7 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, argumentoi se pasqyrimi i gjendjes “arka” ishte gabim i personit që ka plotësuar pasqyrat financiare, pasi realisht ajo gjendje nuk ka ekzistuar, pasi të ardhurat janë tërhequr për t’u përdorur për nevoja familjare, duke iu referuar praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit 48 (në vijim Kolegji), i cili trajtonte një situatë të ngjashme me atë të subjektit të rivlerësimit {...}. Komisioni, pasi u thellua në rastin e Kolegjit, i cili trajtonte një situatë të ngjashme, vlerësoi në analogji me rastin e subjektit të rivlerësimit {...} argumentet e Kolegjit, ku ndër tjerë analizonte se subjektet kanë detyrimin të deklarojnë dhe provojnë të ardhurat e tyre të ligjshme, sipas përcaktimit të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, të ardhura të cilat vlerësohet nëse arrijnë të mbulojnë pasuritë e krijuara prej subjekteve, si dhe shpenzimet e kryera prej tyre në funksion të rivlerësimit të kriterit të pasurisë. Kolegji e konsideron të pambështetur në fakte dhe në ligj qëndrimin e Komisionit, që ka konsideruar si pasuri të njësisë familjare edhe “gjendjen arka”, që figuron e deklaruar në bilancet e personit fizik që zotërohet nga personat e lidhur. Kolegji arriti në konkluzionin

se pretendimi i subjektit për mosekzistencën reale të gjendjes “arka”, sipas deklarimeve në pasqyra financiare, është i besueshëm dhe, për pasojë, njësia familjare nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim në vitet kur ai është pasqyruar si i tillë.

10.8 Komisioni, duke vlerësuar tërësinë e rrethanave, shpjegimet e subjektit, provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe praktikën e konsoliduar të Kolegjit, çmoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit si notere, pasi rezultoi se u provua realizimi i këtyre të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes si person fizik. Gjithashtu rezultoi se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore pranë organeve tatimore dhe, të konfirmuara prej tyre, këto të ardhura janë deklaruar në deklaratat periodike, si dhe në atë Vetting sipas ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi t'i përfshijë ato në vlerën 1,200,000 lekë për vitin 2014, duke mos e konsideruar gjendjen “arka” të pasqyrave financiare. Pasi Komisioni i përfshiu këto të ardhura, rezultati financiar përfundimtar i analizës financiare ishte me një vlerë negative prej -56,393 lekësh, vlerë kjo e cila konsiderohet me një peshë të papërfillshme për t'u marrë në konsideratë si element penalizues për subjektin e rivlerësimit në aplikimin e ndonjë mase disiplinore ndaj tij”.²⁷

Në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të mësipërm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuar, duke konkluduar se: “Komisioni konstaton se nga hetimi administrative nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar po ashtu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit {...}”.²⁸

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

²⁷ Faqe 22-23 e Vendimit nr. 663 datë 23.05.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

²⁸ Faqe 25 e Vendimit nr. 663 datë 23.05.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3.C Paanësia e gjyqtarit.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për gjyqtarin {...}, nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi në 5 dosjet e vëzhguara. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar, përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.*

3.C.A. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari apo në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për gjyqtarin {...}, nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi në 5 dosjet e vëzhguara”.*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë, të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat përgatitore, qoftë në seanca gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjyha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.*

4.A.A komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, regjistrimet e seancave në sistemin audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezultojnë të njëjta cilësi edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se :*“Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidnetuar raste që të ketë patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur”.*

4.B.A. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të

dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se :“*Subjekti i rivlerësimit {...}, është magjistrat i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Krahas përfundimit të kësaj shkolle, i ka kushtuar vëmendje të mëtjshme formimit të tij akademik. Kështu rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kryer gjithashtu “Master Shkencor” në të Drejtën Penale, përfunduar pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në periudhën nëntor 2009 – janar 2012. Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih trajnimet në 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 6 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkollës së parë.*

Në kuadër të trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga dokumentacioni që shoqëron Formularin e Vetëdeklarimit, rezultoi se gjyqtari {...}, në vitet 2005, 2007 e 2008, ka qenë edhe në rolin e “Lehtësuesit” në një sërë seminaresh të organizuara nga shkolla e Magjistraturës në ato vite. Gjithashtu, në vitin 2009, gjyqtari {...}, rezultoi të jetë përzgjedhur nga Shkolla e magjistraturës si ekspert i Programit të trajnimit vazhdues. Krahas trajnimeve të mësipërme të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, rezultoi të ketë ndjekur edhe trajnime të tjera të organizuara nga institucione vendase e të huaja, brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilat janë jashtë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit”.

4.C.A. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 436/1 Prot., datë 17.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë :

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 5 (pesë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 6 (gjashtë) ditë trajnimi.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve²⁹.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se *gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Referuar sa më sipër, pavarësisht se Ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk ka qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të Ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në

²⁹ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : ”1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, gjithsej 5 aktivitete të zhvilluara për 6 ditë. Duke qenë se Ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk ka qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, pjesëmarrja e gjyqtarit do të konsiderohet brenda normës prej 15-120 ditë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, do të konsiderohet nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, për periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u

shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, rezulton që gjyqtari me vendimin nr. 276 datë 06.05.2011 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë është zgjedhur Anëtar, funksion të cilin e ka ushtruar krahas detyrës së gjyqtarit deri më datë 08.04.2016. Pra brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016 rezulton se gjyqtari ka ushtruar edhe funksionin e Anëtarit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke marrë pjesë kështu në mbledhje dhe grupe pune për administrimin e drejtësisë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari. Në rastin konkret vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, duke dhënë

kontributin e tij në hartimin, diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore me angazhimin në veprimtari ndërinstytucionale me një rol aktiv për këtë tregues.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. Publikimet ligjore akademike.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit

93	Shkëlqyeshëm
----	--------------

PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 			<p>E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë</p>	
	Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	<p>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë</p>	
	Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	<p>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë</p>	
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					100	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimet	Shkalla e	Pikët	Metodologjia		

			aftësisë/niveli i treguesit		
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për

		<i>short).</i>			gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Mbi + 99 %	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>6 dosjet e përzgjedhura me short</i>); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9

					<p>pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
<p>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</p>	<p>Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	<p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë</p>	<p>15</p>	<p>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p> <p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë</p>
	<p>Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	<p>Shumë e lartë</p>	<p>20</p>	<p>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</p> <p>E dobët- 4 pikë</p> <p>Nën mesataren – 8 pikë</p> <p>Mesatare – 12 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 16 pikë</p> <p>Shumë e lartë - 20 pikë</p>

C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i	Shmangia e shfaqjes së	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të

gjqtarit	pahijshme, nderi dhe dinjiteti				gjqtarit: E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë

					Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve				
	Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			393		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR